

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së zhvillon takim *online* me drejtuesit e shoqërive të sigurimit

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-nëntor 2020

Zhvillime të tjera

- AMF nxjerr për konsultim publik dhe miraton Rregulloren “Për kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim”

Edukimi i konsumatorit

- OECD përkujton 60-vjetorin e nënshkrimit të konventës për krijimin e saj
- Fjala e Pedro Sánchez, kryeministër i Spanjës dhe Angel Gurría, Sekretar i Përgjithshëm i OECD-së - “Axhendë gjithëpërfshirëse për një rikuperim të fortë, të qëndrueshëm dhe të gjelbër nga Pandemia COVID-19”

Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator ○ Drejtuesi i lartë i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Francës bën thirrje për një mënyrë të re në rregullimin e tregut të fondeve
- Viti 2021 pritet të jetë një vit i ngarkuar për autoritetet rregullatore evropiane

Informacione Ndërkombëtare

- Bullgari
- Poloni
- Serbi
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së zhvillon takim *online* me drejtuesit e shoqërive të sigurimit



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Mete në takim online me drejtuesit e shoqërive të sigurimit

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se edhe pse tregu i sigurimeve rezultoi më i prekuri nga tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së, në tërësi ai paraqitet i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar, i mirëprovigjonuar, si edhe me norma likuiditeti të mjaftueshme.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Mete, zhvilloi më datë 24.12.2020, një takim *online* me drejtuesit e shoqërive të sigurimit. Në takim u diskutua mbi ecurinë e tregut të sigurimeve, treguesit kryesorë financiarë, si edhe ndikimet që pati pandemia COVID-19.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se edhe pse tregu i sigurimeve rezultoi më i prekuri nga tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, në tërësi ai paraqitet i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar, i mirëprovigjonuar, si edhe me norma likuiditeti të mjaftueshme.

Përgjatë këtij viti janë shlyer pjesa më e madhe e dëmeve të tërmeteve të vitit të kaluar (deri në fund të nëntorit, janë paguar 92.5% e kërkesave për dëmshpërblim). Në tërësi, për periudhën janar-nëntor 2020 dëmet e paguara nga shoqëritë e Jo-Jetës u rritën me 31.5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku ndikim patën dëmet nga sigurimi i pronës.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv kërkoi nga shoqëritë e sigurimit që të qartësojnë kushtet e kontratave në lidhje me mbulimin ose jo nga pandemia, si edhe apeloj për një vëmendje të shtuar sa i përket komunikimit dhe transparencës me policëmbajtësit në veçanti për produktet e sigurimit të Jetës dhe shëndetit që lidhen me pandeminë.

Në takim u diskutua gjithashtu mbi pritshmëritë për vitin e ardhshëm dhe masat e nevojshme në kushtet e pandemisë vazhduese, për të garantuar qëndrueshmërinë e tregut të sigurimeve, shëndetshmërinë e treguesve financiarë dhe mbrojtjen e personave të siguruar.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-nëntor 2020

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar-nëntor 2020 arritën vlerën 14,772 milionë lekë, ose 5.51% më pak se në periudhën janar-nëntor 2019. Gjatë periudhës janar-nëntor 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 857,503 me një ulje prej 29.20% krahasuar me periudhën janar-nëntor 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.21% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 6.78%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.41% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.59% të totalit të tregut.


Gjatë periudhës janar-nëntor 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,810 milionë lekë, ose 24.08% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2019.



Gjatë janar-nëntor 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,810 milionë lekë, ose 24.08% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2019.



Struktura e tregut të sigurimeve, Janar - Nëntor 2020



Projektregullore

Faqe Kryesore ▸ Legjislatiioni ▸ Projektakte ▸ Projektregullore

Projektregullore "Për kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim"

Projektregullore "Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese të fondëve dhe depozitarëve në Republikën e Shqipërisë"

Projektregullore "Për formatin e pyetësorit të vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit"

Projektregullore "Për procedurën e certifikimit dhe kualifikimet e punonjësve me funksione kyçe të shoqërisë komisionere"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka hartuar projektregulloren **"Për kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim"**. Kjo rregullore është hartuar në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" i ndryshuar, Ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Ligjit nr. 62/2020 "Për tregjet e kapitalit", Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Projektregullorja dhe shtojcat përkatëse, pasi u publikuan në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, u miratua me Vendim Bordi nr. 198, datë 29.12.2020.

FINANCIAL MARKETS

AMF chair calls for new approach to regulating fund management sector

Justin Pugsley | December 14, 2020



The growth and internationalisation of the fund management industry has raised new challenges calling for a new approach towards regulating it, said the chair of French markets regulator, Autorité des marchés financiers (AMF), which could have implications for cross-border business.

Drejtuesi i lartë i Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës (AMF) bën thirrje për një mënyrë të re në rregullimin e tregut të fondeve

www.globalriskregulator.com

Kryetari i Autoritetit Rregullator të Tregjeve franceze, (*Autorité des Marchés Financiers AMF*) u shpreh se "... Rritja dhe ndërkombëtarizimi i industrisë së fondeve të investimit dhe menaxhimi i tyre ka nxjerrë në pah sfida të reja duke kërkuar një qasje tjetër rregullative, e cila mund të ketë implikime për biznesin ndërkufitar".

Në një intervistë me Financial Times (i cili ka në pronësi edhe "Global Risk Regulator") z. Robert Ophèle, kryetari i AMF-së franceze vuri në dukje se menaxhimi i aseteve ishte bërë një biznes gjithnjë e më global me zyra qendrore në një vend, menaxhim në një tjetër, si edhe investitorë në juridiksione të tjera. Sidoqoftë, menaxherët e këtyre aseteve mbikëqyren edhe nga vendet ku janë vendosur, gjë që krijon një mjedis rregullator të fragmentuar.

Ai bëri thirrje për një kornizë të përshtatshme mbikëqyrëse për industrinë e menaxhimit të aseteve. Ai shpjegoi se natyra ndërkufitare e menaxhimit të pasurive po rritet me një prirje drejt përqendrimit të mëtejshëm dhe marketingut ndërkufitar të fondeve.

Z. Ophèle sugjeroi dhënien e një "statusi të mbikëqyrësit kryesor" për rregullatorin në vendin e BE-së ku bazohet një kompani e administrimit të fondeve, ashtu si ndodh me bankat dhe kompanitë e sigurimeve.

Z. Ophèle sugjeroi dhënien e një "statusi të mbikëqyrësit kryesor" për rregullatorin në vendin e BE-së ku bazohet një kompani e administrimit të fondeve, ashtu si ndodh me bankat dhe kompanitë e sigurimeve.

Expect 2021 to be a busy year for European regulation

Joe McHale | December 7, 2020



A decade on from the sweeping regulatory reforms, which were launched in response to the financial crisis, the next waves of reform are appearing on the horizon. By Joe McHale, head of European Government and Regulatory Affairs at Bloomberg LLP

Viti 2021 pritet të jetë një vit i ngarkuar për autoritetet rregullatore evropiane

www.globalriskregulator.com

Artikulli është shkruar nga Joe McHale, drejtues i divizionit të Qeverisjes Evropiane dhe Çështjeve Rregullatore, Bloomberg LLP.

(Marrë me shkurtime dhe redaktime)

Një dekadë pas reformave rregullatore gjithëpërfshirëse, të cilat filluan si përgjigje ndaj krizës financiare, në horizont po shfaqen valët e reja të reformave.

Për politikëbërësit dhe pjesëmarrësit e tregut, 2020 do të konsiderohet i gjithi si vit në përgjigje të pandemisë globale dhe emergjencës së klimës. Në Evropë, rregullatorët do të duhet të trajtojnë edhe "jetën pas Brexit" dhe të shqyrtojnë me kujdes inovacionet digjitale dhe teknologjike që po transformojnë tregjet.

Artikulli përshkruan disa nga piketat kryesore ku u drejtua vëmendja e industrisë financiare dhe rregullatorëve gjatë vitit 2020 si:

"Financat e gjelbra" kryesojnë axhendën - Kur shpërtheu pandemia, disa kishin frikë se përqendrimi në financat e qëndrueshme do të zvogëlohej. Në vend të kësaj, konsensusi duket qartë, investimi masiv dhe masat rregullatore të kërkuara për të rindërtuar ekonominë tona post-pandemike, duhet të mbështesin kalimin në një ekonomi neto të karbonit zero.

Një tjetër provë në CMU (Bashkimi i Tregjeve të Kapitalit) - Në shtator 2020, Komisioni i BE-së ringjalli planet e tij për të krijuar një Bashkim/Union të Tregjeve të Kapitalit (CMU) me 16 veprime legjislative dhe jo-legjislative të cilat do të ndërmerren në vitin 2021. Këto shkojnë nga krijimi i një platforme në të gjithë BE-në që u siguron investitorëve akses për informacionin e ndërmarrjes, deri te harmonizimi më i madh për disa rregulla për mungesat e aftësisë paguese.

Stabiliteti financiar - Në shpërthimin e pandemisë, rregullatorët lëvizën shpejt për t'i dhënë bankave një hapësirë për të marrë frymë. Ndër masat e ndryshme të ndihmës, zbatimi përfundimtar i Bazeli III u shty me një vit, deri në janar 2023.

Teknologjia dhe inovacioni - Përgjigja ndaj mundësive dhe rreziqeve që mund të vijnë nga inovacioni teknologjik do të vazhdojë të jetë lart në axhendë.

Një dekadë pas reformave rregullatore gjithëpërfshirëse, të cilat filluan si përgjigje ndaj krizës financiare, në horizont po shfaqen valët e reja të reformave.

Axhendë gjithëpërfshirëse për një rikuperim të fortë, të qëndrueshëm dhe të gjelbër nga Pandemia COVID-19

Pedro Sánchez, kryeministri i Spanjës
Angel Gurría, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik - Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD)



Më 14 dhjetor të këtij viti ne kremtojmë 60-vjetorin e nënshkrimit të Konventës për krijimin e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). OECD është pasardhëse e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik Evropian - *Organisation for European Economic Cooperation* (OEEC), e krijuar në 1948 për të administruar ndihmën Amerikane dhe Kanadeze në kuadër të Planit Marshall, për rindërtimin e Evropës pas Luftës së Dytë Botërore. Solidariteti, ambicia dhe bashkëpunimi ndërkombëtar frymëzuan zhvillimin e Planit Marshall dhe krijimin e OECD-së. Sot, mbase më shumë se në çdo kohë tjetër në gjashtëdhjetë vitet e fundit, bota ka nevojë, edhe një herë, të nxjerrë frymëzim nga ato vlera, pasi po përballlet me krizën shëndetësore, ekonomike dhe sociale më të keqe që nga Lufta e Dytë Botërore.

Qëllimi kryesor i OECD-së ka qenë gjithnjë arritja e një mirëqënieje më të madhe për anëtarët dhe partnerët e saj në të gjithë botën, duke këshilluar qeveritë se si të sigurojnë politika që mbështesin një rritje elastike, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. OECD ka ndihmuar në avancimin e reformave strukturale dhe zgjidhjeve shumëpalëshe përballë sfidave globale, nëpërmjet analizave të politikave të bazuara në prova konkrete, si dhe rekomandimeve, standardeve dhe rrjeteve të politikave globale, në bashkëpunim gjithnjë e më të ngushtë me forume shumëpalëshe si: KB, G7 dhe G20. Shembuj të ndikimit të OECD përfshijnë parimin “ndotësi paguan”, i zhvilluar në vitet 1970, vlerësimet e studentëve në kuadër të Programit Ndërkombëtar për Vlerësimin e Studentëve - *Programme for International Student Assessment* (PISA) ose përpjekjet e vazhdueshme për të promovuar transparencën e taksave dhe për të shfrytëzuar potencialin e Inteligjencës Artificiale (IA) me qendër njeriun.

Pandemia COVID-19 nuk ka lënë pa prekur asnjë vend apo rajon. Ndërsa vazhdojmë luftën kundër virusit dhe përgatitemi për rimëkëmbje, përpjekjet tona duhet të plotësohen me një përgjigje po aq të vendosur dhe ambicioze përmes bashkëpunimit ndërkombëtar. Kjo krizë duhet të jetë një mundësi, një pikë kthese për një multilateralizëm të forcuar dhe më efektiv. Ne duhet të punojmë së bashku për të garantuar zgjidhje efektive globale për sfidat e sotme globale: rikuperim nga COVID-19, ndryshimet klimaterike, humbja e biodiversitetit, rritja e pabarazisë, përqendrimi i pasurisë, digjitalizimi ose e ardhmja e punës. Ky ishte mesazhi kryesor nga ministriali i OECD-së kryesuar këtë vit nga Spanja. Për herë të parë në katër vjet, anëtarët e OECD-së lanë mënjanë divergjencat ndërmjet tyre dhe ranë dakord mbi një deklaratë që pasqyron vizionin e tyre kolektiv për një rikuperim të fortë, të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të gjelbër nga COVID-19. Ky ishte një mesazh i fuqishëm: në momentin kur kërkohej më tepër, anëtarët e OECD-së iu përgjigjën kësaj sfide të gjithë njëzëri. Ka ardhur koha për ta vënë në lëvizje këtë vizion, për t'i kthyer fjalët në veprim. Përpjekjet tona kolektive duhet të përqendrohen në tre fusha kryesore.



Prioriteti i parë për rimëkëmbjen duhet të jetë mbrojtja nga virusi dhe eliminimi i tij. Kompromisi midis jetës dhe mjeteve të jetesës është një dilemë false. Prodhimi i vaksinave efikase është një lajm i mirë. Por, për të qenë efikas në luftën ndaj pandemisë, vaksinat dhe trajtimet duhet të prodhohen në një shkallë të gjerë, të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjithë botën dhe të jenë të përbalueshme për të gjithë. Duhet të sigurohet imunizimi i të gjithë njerëzve, si një domosdoshmëri humanitare dhe një parakusht për sigurimin e shëndetit dhe prosperitetit. Nëse sëmundja lulëzon kudo, ajo mbetet një kërcënim kudo. Një sistem i fortë i kujdesit shëndetësor, elastik dhe gjithëpërfshirës është një mësim tjetër i nxjerrë nga kjo krizë dhe duhet të përfshihet në prioritetet kombëtare, por gjithashtu si pjesë e programeve tona të bashkëpunimit për zhvillim. Ne duhet të mbështesim vendet më të rrezikuara, të cilat nuk kanë mundësi financiare për t'u përgjigjur pandemisë dhe nuk kanë sisteme të forta të mbrojtjes sociale për të zbutur efektet e saj në popullatat e tyre.

Prioriteti i dytë është krijimi i kushteve për një rimëkëmbje në një shkallë të gjerë. Ne duhet të punojmë së bashku për të zhvilluar qasje të përbashkëta për të rivendosur lëvizjen ndërkombëtare sa më shpejt të jetë e mundur. Ne gjithashtu duhet të ruajmë përfitimet e tregtisë së lirë, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, si një motor për rritje dhe prosperitet, duke forcuar qëndrueshmërinë e zinxhirëve të vlerave globale dhe duke niveluar fushën e lojës. Bota post-COVID-19 do të jetë më digjitale dhe bashkëpunimi ndërkombëtar është i nevojshëm për të siguruar që ne të adresojmë çështjet e aftësive, privatësisë, sigurisë dhe konkurrencës. Një tjetër qëllim parësor është arritja e një zgjidhjeje konsensuale në nivel global nga mesi i vitit 2021 për sfidat fiskale që vijnë nga digjitalizimi në rritje të ekonomisë botërore, bazuar në nismën e OECD-së.

Prioriteti i tretë është mbështetja e një rimëkëmbjeje transformuese dhe zhvillimi i një narrative të re rreth rritjes ekonomike. Planet kombëtare të rimëkëmbjes dhe qëndrueshmërisë janë mundësi unike jo vetëm për rifillimin e ekonomive tona, por edhe për të ndërmarrë veprime të guximshme dhe transformuese për t'i bërë ato më të barabarta, kohezive dhe miqësore me mjedisin, në përputhje me Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kriza COVID-19 ka rritur pabarazitë, ndërsa ndryshimet klimaterike, humbja e biodiversitetit dhe emergjenca të tjera mjedisore paraqiten si një rrezik i madh para nesh. Analiza e OECD-së tregon se veprimet ambicioze klimatike, për dekarbonizimin e ekonomive tona mund të jenë burime rritjeje, për të ardhurat dhe vendet e punës. COP26 në Glasgow dhe Konferenca e Kombeve të Bashkuara për biodiversitetin, që do të mbahen të dyja në 2021, do të testojnë vendosmërinë tonë kolektive. Përgjegjësia jonë e vetme, më e rëndësishme ndër breza është mbrojtja e planetit.

Kjo është e lidhur edhe me promovimin e një modeli të rritjes ekonomike dhe produktivitetit bazuar në paga të drejta, kushte të përshtatshme pune dhe dialog të zgjeruar shoqëror.

Gjatë dekadës së kaluar, OECD ka qenë zë kryesor në promovimin e një qasjeje ndaj rritjes ekonomike që kombinon gjithë përfshirjen dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Duke u bazuar në prova dhe të dhëna të qëndrueshme, ne duhet të punojmë së bashku për të zhvilluar më tej këtë narrative, duke matur rezultatet përtej PBB-së dhe duke zhvilluar një konsensus rreth një kornize të re ekonomike që bashkërendon njerëzit, prosperitetin dhe planetin.

Po jetojmë kohëra të pazakonta. Sfidat që shtrihen para nesh janë shumë domethënëse që çdo shtet të mund t'i përballojë ato i vetëm. Vetëm përmes veprimit kolektiv do të jemi në gjendje t'i adresojmë ato, si edhe të rindërtojmë në mënyrën më të mirë ekonomi dhe shoqëri më elastike, më gjithëpërfshirëse dhe më të gjelbërta. Me një vizion afatgjatë, ambicie të fortë dhe një ndjenjë të ndriçuar misioni, ndërsa festojmë 60 vjetorin e OECD-së, ne duhet të nxjerrim frymëzim nga historia dhe arrijtjet për të ofruar politika më të mira, për një jetesë më të mirë, për brezat që do të vijnë.

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë (FSC), tregu i sigurimeve në vend, në fund të shtatorit 2020 arriti në 2.16 miliardë BGN ose rreth 1.10 miliardë Euro, duke shënuar një rënie prej 0.87% në terma vjetorë. Primet e shkruara bruto për sigurimin e Jetës u ulën me 13.35%, duke arritur në 327.30 milionë BGN. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 1.74%, duke arritur në 1.84 miliardë BGN.

POLONI

www.xprimm.com

Siç informon Byroja Polake e Sigurimit Motorik, gjatë vitit 2019, pothuajse 3.9 milionë automjete të regjistruara jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) hynë në Poloni përmes kufijve të saj lindorë me Bjellorusinë, Rusinë dhe Ukrainën. Megjithëse trafiku në këto kufij mbetet i lartë, numri i policave kufitare të lëshuara gjatë vitit 2019 pothuajse u përgjysmua në krahasim me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019, siguresit polakë lëshuan 103,000 polica kufitare për shoferët pa një sigurim të vlefshëm të Kartonit Jeshil. Numri u ul ndjeshëm në 2019 krahasuar me 2018, gjatë të cilit u lëshuan më shumë se 200 mijë polica kufitare.

Presidenti i Bordit të Byrosë Polake të Sigurimit Motorik e shpjegoi rënien e ndjeshme me zbatimin e disa shërbimeve kufitare e doganore nga Bjellorusia dhe Ukraina. Shtetasit e këtyre vendeve kur dalin nga kufijtë dhe hyjnë në vendet e EEA, duhet të kenë në zotërim një Karton Jeshil të vlefshëm, certifikatën e lëshuar nga Zyrat e tyre Kombëtare.

Vlera e primeve të marra nga kompanitë polake të sigurimeve për sigurimin kufitar në vitin 2019 tejkaloi 11.2 milionë PLN. Shoferët e pajisur me këto polica kanë shkaktuar 701 dëme, dhe vlera totale e dëmeve të paguara deri më tani arrin në 9 milionë PLN.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë (NBS) gjatë tremujorit të tretë të vitin 2020 tregu i sigurimeve u rrit me 2.17% në terma vjetore, duke arritur një vlerë të primeve të shkruara bruto prej afro 80.73 miliardë RSD ose rreth 68 687 milionë EUR.

Primet e shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës patën një rritje prej 2.20% në terma vjetore duke arritur në 62.63 miliardë RSD, ndërsa primet në sigurimet e Jetës arritën në 18.09 miliardë RSD, duke shënuar kështu një rritje 2.09% në krahasim me vitin e kaluar.

Vlera e dëmeve të paguara arriti në 36.53 miliardë RSD duke shënuar një rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar prej 5.31%.

TURQI

www.xprimm.com

Vlera tavan e primit të MTPL-së në Turqi do të mbetet e pandryshuar edhe për një vit tjetër, duke filluar nga 1 janari 2021. Kjo masë synon të sigurojë një vlerë të përballeshme të këtij lloji sigurimi. Vendimi u mor nga Autoriteti Rregullator dhe Mbikëqyrës i Sigurimit dhe Pensioneve Private (*Insurance and Private Pension Regulation and Supervision Authority*).

Autoriteti rregullues i tregut ka vendosur gjithashtu normën e indeksimit për primet MTPL, që për vitin e ardhshëm do të jetë me 1% çdo muaj. Përfaqësuesit e Shoqatës së të Drejtave të Konsumatorit kanë nënvizuar se kjo është një kohë veçanërisht e vështirë. Shumë njerëz duhet të menaxhojnë transportin e tyre me nivele më të ulëta të të ardhurave, por nga ana tjetër është në rritje tendenca për të shmangur transportin publik për shkak të rreziqeve që lidhen me COVID-19. Në këto kushte, Shoqata e të Drejtave të Konsumatorit kërkon që mbajtja e normave të MTPL-së të jetë në një nivel të përballeshëm.

Vlera tavan e primit MTPL u prezantua në 2017 si një përgjigje ndaj rritjeve të konsiderueshme të primeve në vitet e mëparshme. Rritja e primeve ishte aplikuar në kategoritë e shoferëve me rrezik të lartë, duke përfshirë drejtuesit e taksive, minibusëve, autobusëve komercialë dhe kamionëve. Vendosja e këtij çmimi tavan për MTPL vlerësohet pozitivisht nga konsumatorët, ndërkohë që është një nga arsyet kryesore të humbjeve të mëdha teknike të sigurimeve motorike në vitet e fundit.

Në maj 2019, Ministria e Thesarit dhe Financave të Turqisë shtoi edhe një ndryshim të ri në rregulloren për tarifën MTPL, sipas së cilës kompanitë e sigurimeve mund të përdorin historinë e shoferëve për të përcaktuar çmimin përfundimtar të MTPL-së. Shtesat në rregullore përfshijnë dënime për shoferët, duke specifikuar se shkeljet e rregullave të trafikut mund të përdoren në procesin e vlerësimit të rrezikut për të përcaktuar primet e sigurimit. Në përcaktimin e primit MTPL do të konsiderohet edhe periudha në të cilën shoferit i janë pezulluar dokumentet si edhe arsyet që çuan në këto masa.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al